

DITARI MUJOR MARS 2024



Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës

Ky institucion ka për qëllim të nxisë dhe të promovojë inovacionin dhe angazhimin në administratën publike të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë

AIE është duke rekrutuar bazuar tek aplikimet që u mbyllën në datë 4 Prill.

NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË PËRBASHKËT TË BIZNESIT MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE

Në takim të përbashkët, organizuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, ishte pranishëm një delegacion prej 50 biznesmenësh nga Arabia Saudite, ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Blendi Gonxhja, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, përfaqësi diplomatike dhe komuniteti i përbashkët i biznesit.



“Shqipëria është e gatshme dhe e etur për të mirëpritur investimet dhe bashkëpunimin e huaj. Si ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, jam i angazhuar personalisht t’ju shërbej në çdo mënyrë të mundshme për të eksploruar dhe ndjekur mundësitë e bashkëpunimit dhe investimesh në Shqipëri. Së bashku, le të shfrytëzojmë mundësitë që na presin dhe të ndërtojmë një të ardhme më të ndritshme dhe më të begatë për të gjithë”, u shpreh ministri Gonxhja.

MINISTRI GONXHJA TAKON MËSUESIT E ARSIMIT PROFESIONAL NË 7 MARS

Në ditën e festës së 7 Marsit, u ndalëm tek një prej profileve që çdo ditë e më shumë po merr vëmendjen e duhur, e që sot e meriton plotësisht mbështetjen e të gjithëve - mësuesit e arsimit profesional, që ndiqet çdo vit nga mbi 16 mijë nxënës!

Pikërisht falë përkushtimit të tyre si udhërrëfyes të së ardhmes, rreth 57% e të certifikuarve dhe të diplomuarve në 31 shkollat e mesme profesionale dhe 10 qendrat e formimit profesional publik, punësohen deri në 6 muaj pas përfundimit të shkollës.

Në 1,759 mësime të sistemit AFP në mbarë vendin, 730 prej tyre janë mësues të kulturës profesionale që kontribuojnë në përgatitjen e të rinjve për t'u integruar me sukses në tregun e punës, duke ndikuar në mirëqenien shoqërore dhe në zhvillimin ekonomik të vendit tonë.



VËMENDJE MAKSIMALE PËR RESTAURIMIN DHE RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË GJITHË TERRITORIN

Mirëmbajtja, investimet dhe projektet me bashkëpunorë të huaj, kanë nxjerrë nga lista e riskut shumë objekte Pasuri Kulturore në shumë qarqe, falë ekipeve dhe specialistëve të drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore të Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, sëbashku me mjeshtrat duarartë dhe komunitetet e organet vedore.

Ndërhyrjet restauruese kanë vijuar në:

- Kishat e Shën Triadhës në Tudas dhe Shën Marisë në Lubonjë;
- Shtëpinë muze të Kostandin Kristoforidhit në Elbasan;
- Pikturën murale në kishën e Shën Kollit dhe punime emergjente në Urën e Niçës.

Gjithashtu, është në proces një projekt i rëndësishëm për restaurimin e kishës dhe pikturës murale në ishullin e Maligradit, me mbështjetjen e projekteve IPA.

Investimet kanë nxjerrë nga risku kishën e Shën Marisë, Barmash dhe Shën Kollit në fshatin Shelcan.



Iva Lulashi, përfaqësuesja e Shqipërisë në Bienalen e Venecias

Arti dhe dashuria të pandara në veprat e realizuara mjeshtërisht nga artistja Iva Lulashi, e cila do të përfaqësojë Shqipërinë në edicionin e 60-të të Bienales Ndërkombëtare të Artit në Venecia!

Përmes artit të saj, me projektidenë "Love as a Glass of Water", Iva na fton të bëhemi pjesë e një udhëtimi emocionues, duke kapur çdo nuancë të dashurisë dhe çdo impuls të fshehur të instinktit, si gjuhë universale, forca primare që lidh njeriun me botën!

MINISTRI GONXHJA, TAKON DHE VLERËSON KONTRIBUTIN E ARTIZANËVE

Mes Komitetit të Gruas Sipërmarrëse Zejtare, pjesë e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, Delegacioneve nga Gjermania, Ukraina dhe Rajoni, ku u vlerësuan me titullin "Mjeshtër" disa prej zejtareve që kanë mbaruar me sukses testimin përkatës. Mbështetja e zhvillimit të kualifikimit profesional në fushën e zejtarisë, përmes programeve të trajnimit dhe të kualifikimit ku zejtaret kanë mundësinë për të avancuar në karrierën e tyre dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre në prodhimin dhe ofrimin e produkteve, do të bëjë që ky vit të jetë viti i aftësimin profesional dhe i ndihmës për pasurimin e këtij komuniteti të jashtëzakonshëm.





Parafirmoset Marrëveshja Kuadër në fushën e sigurimeve shoqërore.

Për palën shqiptare kjo marrëveshje u parafirmos nga Zëvendësministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, znj. Olta Manjani, ndërsa për palën serbe nga përfaqësuesi i Ministrisë së Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale, z. Zoran Milosevic.

Marrëveshja iu siguron qytetarëve shqiptarë një sërë përfitimesh, si: pensionin e pleqërisë, përfitimet e barrë lindjes, pensionin familjar, atë të invaliditetit, etj. Ajo gjithashtu siguron bashkimin e periudhave kontributive, duke bërë që qytetarët të mos humbasin vitet e tyre të punës.

"Terminal për Tiranën" një instalacion artistik unik, i vendosur në hyrje të Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, nga artistja polake Karolina Halatek, kuruar nga

NË PANAIRIN "INVESTO NË VERI-PUNË, EDUKIM DHE KARRIERË"



Në Panairin "Investo në Veri - Punë, Edukim dhe Karrierë" organizuar nga Ambasada Britanike në Shqipëri dhe Dhoma Britanike e Tregtisë. Ky panair vjen si një platformë dhe udhërrëfyes i dedikuar për fuqizimin e individëve, nxitjen e rritjes dhe hapjen e rrugëve të reja drejt zhvillimit në rajonin verior të Shqipërisë. Mbështetja për të rinjtë që kanë nevojë për shkollim të vazhdueshëm ose për të fituar aftësi të reja, dhe shërbimet e këshillimit për karrierën janë instrumente thelbësore për të ndihmuar në rritjen e vetëbesimit dhe gatishmërisë për të përballuar sfidat e zhvillimit personal dhe profesional dhe për më tepër për të nxitur punësimin në vendin ku ata jetojnë.

ARTI NË HAPËSIRAT PUBLIKE

Adela Demetja - Tirana Art Lab në bashkëpunim me arkitektët Elian Stefa dhe Dea Buza.

"Terminal për Tiranën" është një ndër projektet fituese të thirrjes "Art në Hapësira Publike", e cila synon përfshirjen e artit si pjesë integrale e komunitetit, duke i kthyer këto vepra në pika interesi turizmi kulturor.

MEKI do të vijojë të mbështesë projekte të tilla, si një mundësi për të sjellë artin dhe kulturën më pranë nesh.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI SHQIPËRI – ÇEKI

Takim intensiv pune me delegacionin çek, kryesuar nga Ministri i Industrisë e Tregtisë, Shkëlqesia e tij Z. Josef Sikela, me koordinimin e AIDA - Albanian Investment Development Agency dhe MEPJ, për rritjen e investimeve dhe shkëmbimeve tregtare me Çekinë, afrimin kulturor e promovimin e turizmit, mbështetjen në procesin e anëtarësimit në BE!

Sipërmarrja në një treg të ri është e mbushur me sfida dhe pasiguri, ndaj siguroam për përkushtimin tonë për investitorët çekë në çdo hap të këtij rrugëtimi, në interesin e përbashkët ekonomik të të dyja vendeve.

Nënshkruam marrëveshje dypalëshe angazhimi konkret, duke zgjeruar grupet e punës së Komisionit Zyrtar ndërinstitucional Çeki - Shqipëri! Një numër përfaqësuesish nga biznesi e nga dhomat e tregëtisë e pasuruan dialogun me takimet e frytshme B2B.



ZHVILLOHET KONFERENCA KOMBËTARE PËR ARSIMIN PROFESIONAL



Në Konferencën Kombëtare për Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP), së bashku me Kryeministrin e Shqipërisë, Z. Edi Rama, Ambasadorin e Zvicrës në Shqipëri, Znj. Ruth Huber, Ambasadorin e BE-së në Shqipëri, Z. Silvio Gonzato dhe Përfaqësuesen e Përhershme të UNDP-së në Shqipëri, Znj. Monica Merino.

Një konferencë e cila synon të çojë përpara axhendën e reformës së AFP-së, në përputhje me tendencat demografike, zhvillimet teknologjike, digjitalizimin dhe nevojat e sektorëve prioritarë të tregut të punës dhe ekonomisë.

Nënvizon nevojën kritike për përmirësime strategjike të AFP-së për të ndërtuar një forcë punëtore të qëndrueshme për ekonominë shqiptare.

Së bashku me partnerë strategjikë, për të shqyrtuar rolin e sistemit të AFP-së në zhvillimin e kapitalit njerëzor, në funksion të vendeve të punës dhe profesioneve të ardhshme, si dhe në aspektin e pjesëmarrjes dhe kapacitetit të plotë prodhues, përmes politikave të Arsimit dhe Formimit Profesional.

MBLIDHET KËSHILLI I INVESTIMEVE/ KRIJIM I NJË KLIME SA MË TË FAVORSHME PËR BIZNESIN



Mbledhja e Këshillit Shqiptar të Investimeve 2024, për adresimin e sfidave me të cilat përballen sipërmarrësit, veçanërisht në lidhje me politikat dhe administratën fiskale. Fokus tek ngritja dhe miratimi i rekomandimeve, të cilat lehtësojnë punën dhe rrisin konkurrencën.

Përmirësimi i komunikimit mes sipërmarrësve dhe administratës tatimore, si dhe modernizimi dhe dixhitalizimi i shërbimeve është një hap i rëndësishëm për të rritur efikasitetin dhe transparencën.

Do të jemi krah sipërmarrjes për të lehtësuar e nxitur punën e tyre, si motori kryesor për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Krijimi i një klime sa më të favorshme për biznesin mbetet një ndër prioritetet tona kryesore, drejt një tregu me standarde e siguri cilësie.